



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Adresa: Bulevardi "Zogu I", Godina 57/2, Nr.18 Tirane

Tel/Fax 04 2226814 ; 2226814

Nr. 624 Prot.

Tiranë, më 09.10. 2015

V E N D I M

Nr. 109 , datë 09.10/2015

“Mbi verifikimin e procedurës së konkurrimit për plotësimin e pozicionit “Përgjegjës Sektori” në Sektorin e Administrimit të Tokës, në Ministrinë e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave”

Në mbështetje të kompetencave të parashikuara në nenin 11, pika 1, nenet 14 dhe 15 të ligjit nr.152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, neneve 16 e 34 të Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me Vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, pas shqyrtimit të dokumentacionit dërguar nga Departamenti Administratës Publike, administruar pranë Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil me shkresën nr. 620/3, datë 21.09.2015,

VËREJ SE:

Procedura e konkurrimit për ngritje në detyrë, për pozicionin e punës “Përgjegjës Sektori” në Sektorin e Administrimit të Tokës, në Ministrinë e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave”, ka filluar me shpalljen zyrtare në faqen e internetit të Departamentit të Administratës Publike. Në bazë të një informacioni të ardhur pranë Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil është ngritur pretendimi se në kryerjen e këtij konkurrimi janë kryer dhe lejuar kapërcime dhe shkelje të karakterit procedural, të cilat kanë pasur qëllim për të favorizuar nëpunësen që është shpallur fituese e këtij pozicioni.

Nga ana e Departamentit të Administratës Publike, mbi bazën e kërkesës së institucionit përkatës është bërë shpallja e konkurrimit për pozicionin “Përgjegjës i Sektorit të Administrimit të Tokës, në Ministrinë e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave”. Ky veprim administrativ ka filluar me shpalljen e bërë në portalin e Shërbimit Kombëtar të Punësimit dhe në faqen e vet zyrtare duke përcaktuar se konkurrimi për këtë pozicion, fillonte me mundësinë e plotësimit nëpërmjet lëvizjes paralele dhe nëse nuk plotësohej në këtë mënyrë kalonte në konkurrimin për ngritje në detyrë. Në këtë shpallje ishin përcaktuar kërkesat e përgjithshme dhe ato të posaçme që duhej të plotësonin konkurentët , siç parashikohet nga dispozitat e Kreut II dhe III të VKM nr. 242, datë 18.03.2015, “Për Plotësimin e Vendeve të Lira në Kategorinë e Ulët dhe të Mesme Drejtuese”, si dhe afati i dorëzimit të dokumenteve (për lëvizje paralele ka qenë data 10 Gusht 2015 ndërsa për ngritjen në detyrë ka qenë data 15 Gusht 2015). Në përfundim të

verifikimit paraprak të kandidatëve për përmbushjen e kushteve dhe kërkesave të posaçme për lëvizjen paralele DAP, ka shpallur në portalin e Shërbimit Kombëtar të Punësimit mungesën e kandidaturave të kualifikuara për lëvizje paralele, për të vazhduar fazën e dytë të ngritjes në detyrë. Gjithashtu ka bërë me dije se duke filluar nga data 25 Gusht 2015, do të njoftohen nëpërmjet faqes së DAP, të gjithë kandidatët që kanë aplikuar për procedurën e ngritjes në detyrë në lidhje me pozicionin e punës si më sipër.

Nga verifikimi i mëtejshëm rezultoi se, për ngritje në detyrë për këtë pozicion pune, kanë aplikuar dy kandidat të cilët, pas verifikimit paraprak të kushteve dhe kërkesave të posaçme për procedurën e ngritjes në detyrë, janë njoftuar nga DAP nëpërmjet e-mailit në datën 25 gusht për skualifikimin e tyre, duke vlerësuar se kanë të drejtën e ankimit, brenda 3 ditëve, pranë Departamentit të Administratës Publike.

Ndaj vendimit të mësipërm ka paraqitur ankesë vetëm nëpunësja *****, duke sqaruar se titulli i diplomës së saj është *"Inxhinieri Kimike"*, pra përfshihet në grupin e diplomave të shkencave inxhinierike, siç kërkohet në përshkrimin e punës së këtij pozicioni duke hedhur poshtë pretendimin e skualifikimit se ajo është diplomuar në shkenca natyrore, dega kimi-industriale.

Pas shqyrtimit të kësaj anekese, Departamenti i Administratës Publike, në datë 27 Gusht 2015, njofton konkurrenten në fjalë se ankesa është pranuar dhe se është kualifikuar për fazën e dytë të procedurës së ngritjes në detyrë për pozicionin e punës *"Përgjegjëse e Sektorit të Administrimit të Tokës, në Ministrinë e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave"*. Testimi me shkrim dhe intervista do të zhvilloheshin në datën 07 Shtator 2015, ora 11:00, në ambjentet e DAP, njoftim i cili është bërë edhe me shkresën nr. 4068/1, datë 28.08.2015.

Pasi është përfunduar dhe kjo fazë e konkurrimit, në datën 08 Shtator 2015, kandidatja ***** është njoftuar se është përzgjedhur si fituese për këtë pozicion pune duke marrë 90.4 pikë, në total.

Duke analizuar gjithë sa më sipër, arrij në përfundimin se jemi para një procedure të rregullt konkurrimi, të kryer sipas kërkesave të nenit 26, të ligjit 152/2013, *"Për nëpunësin civil"*, i ndryshuar, si dhe VKM-së 242, datë 18.03.2015, *"Për Plotësimin e Vendeve të Lira në Kategorinë e Ulët dhe të Mesme Drejtuese"*. Kështu, konstatohet se, në zbatim të pikës 7 të kreut III të aktit nënligjor të sipërpërmendur, me Urdhrin nr. 70/2, datë 05.07.2015, është ngritur Komiteti i Pranimit për Ngritjen në Detyrë për pozicionin *"Përgjegjës Sektori në Sektorin e Administrimit të Tokës, në Ministrinë e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave"* përbërja e të cilit është e rregullt, sipas kërkesave ligjore. Në përfundim të dy fazave të konkurrimit, kandidatja *****, me Vendimin nr. 1, datë 07.09.2015, të KPND, është përzgjedhur si fituese e pozicionit *"Përgjegjës Sektori në Sektorin e Administrimit të Tokës, në Ministrinë e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave"*. Me shkresën nr. 4301/1, datë 14.09.2015 të Departamentit të Administratës Publike drejtuar ***** dhe ****

***** në cilësinë e Sekretarit të Përgjithshëm në Ministrinë e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave, janë bërë me dije se nëpunësja ***** është emëruar nëpunëse civile në pozicionin *"Përgjegjës Sektori në Sektorin e Administrimit të Tokës, në Ministrinë e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave"*.

Për këto arsye,

Në mbështetje të kompetencave ligjore të përcaktuara në nenin 11, pika 1, nenin 14 të ligjit nr.152/2013, "Për nëpunësin civil", i ndryshuar, si dhe nenin 34 të Rregullores "Mbi Procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit", të miratuar me Vendimin nr.17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

V E N D O S A :

1. Përfundimin e procedimit administrativ për verifikimin e procedurës së konkurrimit për ngritje në detyrë, për pozicionin e punës "*Përgjegjës Sektori*" në Sektorin e Administrimit të Tokës, në Ministrinë e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave".
2. Të njoftohet për këtë vendim Departamenti i Administratës Publike.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Pranvera STRAKOSHA